

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 342, Datë 23.12.2025

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SH.P.K. PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET BARRËSIMIT) TË ASETEVE FIKSE TË SAJ

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar; neneve 4, gërmat “a” dhe “b”, nenit 5, gërma “j”, nenit 6, 7 dhe 8 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikave 1.3 dhe 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 2627/3 prot., datë 19.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për Marrjen e Autorizimit

- Shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 237, datë 22.09.2022, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për Centralin Fotovoltaik me kapacitet 10 MW, me vendodhje në Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku i Fierit.
- Shoqëria me shkresën me nr. 2627/2 prot., datë 03.12.2025 ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për të vendosur kolateral asetet fikse të të licensuarit, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj Raiffeisen Bank sh.a..
- Lidhur me sa më sipër, nga ana e Raiffeisen Bank sh.a. është përcjellë, në ERE, një shkresë me nr. 2627 prot., datë 14.10.2025 “Deklaratë angazhimi” në lidhje me vazhdimësinë e operacioneve të të licensuarit kundrejt shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k..
- Në rrethanat kur nga shoqëria nuk është përcjellë asnjë dokumentacion/informacion, ERE me shkresën nr. 2627/1 prot., datë 27.10.2025 i ka bërë me dije shoqërisë se është njoftuar nga Raiffeisen Bank sh.a. në lidhje me nënshkrimin e një kredie për financimin e parkut fotovoltaik, si dhe i ka sjellë në vëmendje se është një subjekt i licensuar, të cilit i lind detyrimi për të kërkuar miratimin e ERE-s, referuar përcaktimeve të legjislationit në fuqi si dhe neneve 2 dhe 4, gërma “b” të rregullores me nr. 119/2016 ku citohet se ERE jep miratimin për transferimin e aseteve fikse të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së

licencuar, të cilat duhet të jenë në vlerë më të madhe se 150,000,000 lekë. Si e tillë, nëse kontrata e kredisë është lidhur pas licencimit dhe nëse totali i aseteve të lëna peng plotëson vlerën e më sipër cituar, subjekti duhet të depozitojë në ERE aplikimin me të gjithë dokumentacionin bashkëlidhur, konform sa kërkuar në nenin 7 të rregullores në fuqi.

2. Shqyrtimi i Kërkesës dhe Dokumentacionit të Paraqitur

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe të neneve 2, gërma “a”, 3, 5, gërma “j” dhe 6 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licensuarave për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licensuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit”, rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Neni 7, Pika 1

- **gërma “h”** Shoqëria ka depozituar në ERE disa kontrata kredie datë 19.04.2021, datë 13.10.2021, datë 24.08.2022 dhe datë 02.09.2025, por vlerësohet të bëhen sqarimet përkatëse në lidhje me vlerën totale të kredisë së nënshkruar me bankën si dhe të faktit që disa kontrata kredie janë nënshkruar para se kjo shoqëri të kishte statusin e të licensuarit nga ERE, pra përpara se subjektit t’i lindte detyrimi të merrte miratimin nga ERE. Nga analizimi i kontratës së hipotekës datë 18.11.2025, të përcjellë në ERE në kuadër të aplikimit, jemi vënë në dijeni se ka pasur ndryshime të kontratave fillestare dhe nënshkrimi i kontratave të reja është bërë pas periudhës së licencimit nga ERE, të cilat nuk janë depozituar nga shoqëria në kuadër të këtij aplikimi, si e tillë duhet të depozitohet për t’u njohur me përcaktimet e tyre.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI